RAPORTI TEKNIK

OBJEKTI:"RIKONSTRUKSION I SHESHIT MBRAPA BASHKISE PEQIN"

PROJEKT ZBATIMI

QERSHOR 2016

Open Procurement Albania

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1. – TË PËRGJITHSHME

1.1 – Hyrje
1.2 – Pozicioni i objektit
1.3 – Gjëndja Ekzistuese
1.4 – Studimi Topografik

2. - ZGJIDHJA E PROJEKTIT

2.1 – Konceptimi i Projektit
2.2 – Projekti i Rrugeve dhe Trotuareve
2.3 – Rrjeti K.U.SH.
2.4 – Rrjeti i Vaditjes
2.5 – Sistemi i Ndriçimit Rrugor
2.6 – Sinjalistika Rrugore
2.7 – Konkluzione

3. – PREVENTIVI I PUNIMEVE

Open Procurement Albania

1.- TË PËRGJITHSHME

1.1 - HYRJE

Historiku i Qytetit të Peqinit

Peqini shtrihet ne pjesen qendrore te Shqipërise. Klaudiana-Biklinet-Peklin-Peqin Peqini eshte nje vendbanim i lashte ilir, ne bregun e djathte te Shkumbinit te poshtem. Gjetjet arkiologjike deshmojne per faktin se ai ka ekzistuar njeheresh me qytetet me te lashte te vendit tone. Pozicioni gjeografik, ia jepte atij nje mundesi te tille, duke qene i vendosur pergjate rruges se vjeter te KANDAVISE e me pas te asaj EGNATIA, i njohur me emrin KLAUDIANA. Ne burimet historike te vitit 1431 therritet me emrin BIKLINET dhe me pas PEKLIN. Gjate mesjetes se vone u zhvillua si qebder tregtaree zejtare E kaluara e lashte, sidomos ajo mesjetare, pasqyrohet ne momumente historike te qytetit, si Kalaja e Peqinit dhe xhamija me kullen e sahatit. Nga te gjithe vizitoret e huaj Peqini dhe krahina e tij permendet per popullin e tij bujar e mirkprites,per shtepite e kopshte te bukura, kodrat e veshura me ullij e gjelberim si dhe fushen e gjere pjellore, qe lumi Shkumbin i pershkon fund e krye. Ne Peqin eshte parashikuar te kaloje rruga e, Korridorit te tete, cka do ti sjelle kesaj zone mjaft favorizime ekonomike. Peqini i perket krahines se shqiperise se Mesme dhe si i tille folklorike veshjet jan tipike te kesaj krahine Perjashtim ben vetem zona e Darsise, ne te majte te lumit, ku vihen re ndikimet te krahinave jugore. **Rrethi i Peqinit** është njëri nga 36-të rrethet e Shqipërisë. Rrethi bën pjesë në Qarkun të Elbasanit. Rrethi i Peqinit ka 33,000 banorë (sipas 2004).

Pershkrimi i Pergjithshem i zones se Projektit

Sheshi qendror i qytetit i cili sot ka konfiguracionin e nje lulishteje te gjelberuar i cili pershkruhet nga rrugica te vogla dhe rrethuar me nje sistem rrugor kuadratik te asfaltuar.
Ky qytet është një qytet i përmendur gjithashtu për zhvillimin e ekonomisë bujqësore dhe blegtorale.

1.2 - POZICIONI I OBJEKTIT

Zona ne te cilin shtrihet objekti i "**Rikonstruksioni sheshit mbrapa Bashkise**" **Bashkise PEQIN** - ndodhet në qendër të qytetit të Peqin.
Ky objekt rikonstruksion i sheshit mbrapa bashkise,ka nje impakt te larte ne zone.

Objekti kufizohet:
Në veri – Godina e Bashkise Peqin
Në jug – Pallat 5 kat
Në perëndim - Pallat 5 kat
Në lindje - Rruga Sulejman Pasha
duke krijuar nje zone me sipërfaqe totale prej 1970m2.

Objekti që parashikohet të trajtohet perfshihet si pjese e territorit administrativ të Bashkise Peqin.




Xhamia
Enver Mustafa Karina
Gazment Vogli
Idriz Haxhi Shega
Kalaja E Qytetit
Tregtior
Dashamir Ishuli Malkija
Dashnor Malkija
Dionis Hysen Malkija
Hysen Ismail Malkija
Merita Selim Malkija
Naim Yll Malkija
Ardan Yll Malkija
Yll Mehdi Malkija
Ali Ethem Gripshi
Edmond Cani
Ilmi Gripshi
Bardhyl Gripshi
Suzana Dudulci
Gazmenta Gjonaj Daja
Shtet

1.3 – GJENDJA EKZISTUESE

Sheshi pas bashkise, në ka nje siperfaqe te pergjithsshme rreth 1970m2 dhe konturohet nga te kater anet me objekte.
Sheshi nuk ka qene i sistemuar dhe gjelberuar me pare. Aktualisht prej shume vitesh ne te nuk jane kryer investime dhe niveli i mirembajtjes eshte i ulet.
Persa i perket pjeses se gjelberimit: Gjelberimi nuk ka patur asnjehere ky shesh. Gjelberimi i ulet eshte pothuaj i rrenuar.
Ne kete zone nuk ka asnje mobilim si,stola,ndriçues etj.
Rruget automolistike qe konturojne parkun jane ne gjendje te mire dhe te trajtura vitet e fundit.

Pamje te gjendjes ekzistuese te Sheshit.

A e kemo
ELELEZI
VIP

Kryqezimi Automobilistik

Ne pjesen lindore te sheshit, paralelisht me te shtrihet rruga Sulejman Pasha. Kjo rruge pergjate saj kryqezohet me bulevardin Mustafa Gjinishi

Open Procurement Albania

Ujesjellesi: Rrjeti i furnizimit me uje ne kete zone paraqitet ne gjendje te mire. Ne kete zone jane te shtrira linjat e ujesjellesit qe fuksionojne mire dhe nuk ndikojne ne pjeset e Projektit.

Sistemi KUZ: nuk eshte i shtrire plotesisht ne kete zone, paraqitet ne gjendje te mire, funksionale dhe nuk ndikone ne punimet qe do te realizohen per rikualifikimin e parkut.

Sistemi KUSH: Rrjeti kanalizimeve të ujrave të bardha ne brendesi te parkut pothuaj nuk ekziston.

1.4 – STUDIMI TOPOGRAFIK

Zona ne te cilin shtrihet objekti **"Rikonstruksion I sheshit pas bashkise"** ndodhet në qendër të qytetit të Peqinit.
Per hartimin e projektit dhe per nxjerrjen e nje serie te dhenash jane shfrytezuar hartat topografike te zones ne shkallet 1:25.000 dhe 1:10.000, fotot ajrore dhe satelitore te zones si dhe matjet e drejtperdrejta ne terren.

Harta bazë e perdoruar ne shkallan 1:25.000 është:

Harta me Nomenklature K-34-100-(217-C)

Hartat bazë te perdoruara ne shkalla 1:10.000 janë:
Harta me Nomenklature K-34-100-D-C-1

Punimet Gjeodezike

Punimet gjeodezike dhe topografike per objektin **"Rikonstruksion I sheshit mbrapa bashkise"** u kryen mbi bazen e kerkesave teknike te pergjitheshme dhe specifike te parashikuara nga Investitori. Grupi i Topografeve organizoi punen dhe zhvilloi punimet ne baze te pervojes se perftiuar ne punimet e meparshme te kesaj natyre. Para fillimit te punimeve topografike u siguruan materialet e nevojshme hartografike, gjeodezike si dhe paisjet perkatese.

Rilevimi eshte bere ne sistemin nderkombetar me projeksionin UTM me ellipsoid WGS84. Duke patur parasysh zonen dhe ritmin e zhvillimit qe ajo ka, do te ishte me frytedhense nese do te perdorej dhe ky sistem. Me kete sistem mund te percaktohet lehtesisht kordinatat gjeodezike per cdo pike mbi siperfaqen tokesore nepermjet perdorimit te GPS.

Gjate rikonicionit ne terren u vendosen pikat e triangulacionit dhe markat e nivelimit ne pikat e fiksuara ne teren. Pikat e fiksuara ne teren

u pajisen me koordinata ne projeksionin UTM ellipsoid WGS84 dhe kuota. Para fillimit te rilevimit u krye rikonicioni i detajuar i terrenit, i cili sherbeu per percaktimin e sakte te metodikes se punes, menyren e ndertimit te rrjetit gjeodezik, poligonometrise se rilevimit, nivelimit teknik si dhe organizimit te punes. Matjet u kryen me Teodolit,te cilet teknikisht siguron matjet e kendeve e largesive me saktesine e nevojshme per projektimin e rrugeve dhe parqeve.



Rilevimi

Duke u mbeshtetur ne pikat e poligonometrise dhe te nivelimit gjeometrik u zhvillua procesi i matjeve topografike.
Eshte rilevuar ne menyre te plote e gjithe siperfaqja e zones ku shtrihet objekti si dhe e nje brezi perimetral qe e qarkon ate. Ne reliev jane pasqyruar ne menyre te plote te tere elementet perberes te tij. Çdo pike e mare ne teren ka koordinata tre dimensionale. Ky reliev sherbeu per hartimin e projektit te zbatimit me saktesine dhe cilesine e kerkuar.
Ne materialin grafik te projektit jepet planimetria e kuotave.

Pershkrimi i punes ne terren.

Per mbeshtetjen e punimeve fillimisht u krijua bazamenti gjeodezik ne formen e nje poligoni te hapur (pika te forta) te cilat jane te mjaftueshme per marrjen (matjen) e pikave detaje te rilevimit

2. - ZGJIDHJA E PROJEKTIT

2.1 – KONCEPTIMI I PROJEKTIT

Sheshi pas Bashkise pozicionohet ne qendren te qytetit te Peqinit.Territori ku shtrihet aktualisht ky shesh kufizohet ne anen veriore me godinen e bashkise,ne anen perendimore me pallat 5 kat dhe anen jugore eshte I kufizuar me pallat 5 kat.Ne afersi te sheshit ndodhen godinat e Bashkise,Pallatit te Kultures,Xhamia Peqin.Jane te shumte monumentet dhe objektet kulturore, social ekonomike e politike qe ndodhen ne kete shesh ose pergjate perimetrit te tij. Te tille mund te permendim ndertesen e Bashkise se Peqinit, si dhe nje sere monumentesh me rendesi jo vetem lokale .

Ky shesh eshte mjaft i demtuar po ashtu dhe fasadat qe e rrethojne kete shesh. Mungon komplet dhe mobilimi urban i ketij sheshi.



Open Procurement Albania

Procurement Albania



Open Procurement Albania



Open Procurement Albania



Open Procurement Albania

Ne vijim, jane ruajtur disa pasazhe kembesore, pasazhe qe lidhin rrugen "Sulejman Pasha" me Bulevardin "Mustafa Gjinishi". Keto pasazhe respektojne orientimin aktual te rrugicave te sheshit si dhe ruajne drejtimin.
Gjithashtu jane krijuar edhe disa rrugica te reja kembesore te cilat rimarin edhe orientimin tradicional, te lashte te qytetit.

Projekti trajton me nje kujdes te vecante zonen ne mbrendesi te objekteve qe e rrethojne. Ky trajtim rrit aksesibilitetin e kesaj zone dhe ben me te lexueshem kontekstin historik e kulturor te saj. Ne kete shesh parashikohet nje hapesire argetimi per femije si dhe gjelberim I pjeses me te madhe te sheshit. Ne kete shesh jane parashikuar stola,ndriçues vertikale dhe spote ne pjesen e gjelberuar.Ky shesh do te mobilohet dhe gjelberohet ne menyre harmonike me te gjithe elementet qe e rrethojne per te krijuar nje ambjent sa me çlodhes dhe gjallerues.
Se fundmi, por jo me pak e rendesishme eshte dhe trajtimi i gjelberimit te parkut. Krahas sistemimit, krasitjes dhe mirembajtjes se

gjelberimit ekzistues, projekti propozon dhe mbjelljen e pemeve.

2.2 – PROJEKTI I RRUGËVE DHE TROTUAREVE

Projekt Zbatimi per **"Rikonstruksion I sheshit mbrapa Bashkise Peqin"**eshte realizuar ne baze te Detyres se Projektimit te hartuar nga Bashkia Peqin.

Meqenese edhe per nga ana funksionale, ky objekt ruan po te njejtin destinacion, synim i projektit eshte krijimi dhe futja e nje koncepti te ri ne shfrytezimin te sheshit, duke i dhene atij me teper jete e gjalleri. Nje nga objektivat kryesore eshte berjen sa me te shfrytezueshem dhe sa me atraktiv te ketij sheshi.

Per kete qellim, projekti parashikon riformorminin e rrugicave permes tij, duke i kryqezuar ato midis tyre, per krijimin e pikave te kontaktit.Ne shesh jane parashikuar stola per qytetaret. Rrugicat e sheshit do shtrohen teresisht. Pjesa me e madhe e siperfaqes se rrugicave eshte parashikuar te shtrohet me betonele.

- **Zgjidhja Planimetrike.**

Në zgjidhjen Planimetrike është patur parasysh sistemimi dhe trajtimi i te gjithe hapesires qe perfshin tere sheshin, rrugicat brenda tij, dhe hapsirat e gjelberta me tere elementet urbane.

Nderhyrjet ne trupin e rruges dhe trotuare konsistojne ne:

a) Unifikimin e sheshit me tere hapsiren urbane qe e rrethon ate
b) Unifikimin e rrugicave duke e kthyer ne nje zone te shfrytezueshme dhe komode.
c) Krijimin e nje hapsire te gjelberet te perbere nga tre brezat e bimesise ate te ulet te mesme dhe te larte te kombinuara midis tyre.
d) Vendosjen e nje ndricimi relativisht te ulet me shtylla dekorative ne tere rrugicat e sheshit. Kjo do beje shfrytezimin e ketij territori edhe ne oret e mbremjes, duke e kthyer nga nje zone te vdekur ne oret e mbrembjes, ne nje zone aktive dhe te gjalle.
e) Vendosjen e nje ndricimi te larte ne pikat hyrese te sheshit.Kjo per te evidentuar me qarte pikat e hyrjes dhe per te nxjerre me ne pah baziliken duke i dhene edhe nje peshe me te madhe.

- **Zgjidhja Altimetrike.**

Nga ana altimetrike relievi faktik ne drejtim gjatesor eshte pothuajse e sheshte me nje pjerresi te lehte ne drejtim te rruges nga veri-perendimi ne jug-lindja. Kjo pjerresi do te ruhet dhe do sherbeje si baze per kullimin e ujrave siperfaqesore. Eshtë synuar që niveletat e rrugicave te jete sa me uniforme dhe pa shkallezime. Per kete qellim pothuaj e gjithe siperfaqja e rrugicave do te germohet per ta sjelle ne kuote uniforme perfundimtare.

Profilat Tip dhe Detajet

Në Profilat Tip, janë paraqitur në mënyrë të detajuar:
Shtresat Rrugore
- Dimensionet e tyre
- Vendosja e tyre

- Distancat
  - Zona ku aplikohet Profili Tip
  - Pozicioni i rrjeteve te tjera inxhinierikë.

Në detaje janë paraqitur:
Dimensionet e Bordurave
- Markat e Betonit
- Mënyra e fiksimit të Bordurave
- Mënyra e shtrimit të Trotuareve
- Vendkalimet për njerëzit me aftësi të kufizuar.

Zgjidhja Sociale.

I eshte keshtuar vemendje rritjes se vleres ne teresi te zones, kthimi ne zone pedonale, krijimi i mundesive per qendrim ne kohe me te gjate dhe ne menyre me terheqese per banoret.
Po keshtu pergjate rruges eshte parashikuar vendosja e stolave ne menyre qe kembesoret te akomodohen ne objekt.
Trajtim i vecante i eshte ribere edhe lulishtes, duke e shnderruar ate nga nje zone aktuale tregtimi jo normale, ne nje lulishte te mirefillte per shplodhjen e qytetareve. Edhe vete trajtimi, i saj me plane te pjerret, ka patur si qellim jo vetem krijimin e nje imazhi te ri, por edhe eliminimin praktikisht te zonave te shitjes.

Shtresat e Rrugicave dhe të Rrugës

Nisur nga eksperinca ne projektimin e rrugeve, studimi e zones dhe prespektiven e zhvillimit, vleresimi i gjendjes aktuale, trajtimi I zonave me shtresa rrugore do te behet si me poshte:

Zona e Trupit te rruges do te kete keto shtresa rrugore

Fillimisht do te behet skarifikimi i sheshit ekzistues, e me pas germimi ne forme kasonete sipas kuotave te projektit i trupit te rruges.
Kasoneta do cilindrohet dhe do verifikohet nese ka ndonje zone problematike qe do trajtim te vecante.
Me pas do te procedohet me shtresen e zhavorrit me ane te se ciles do realizohet edhe profilimi i rrugicave dhe shesheve si ne drejtim terthor ashtu edhe gjatesor. Per rrjedhoje trashesia e kesaj shtrese ne veper nuk do jete uniforme.
. Gjate betonimit ti kushtohet kujdes, pjerresive terthore.

Zona e Trupit te rruges do te kete keto shtresa rrugore

Asfaltobeton	- 4 cm
Binder	- 4 cm
Konglomerat Bituminoz	- 10 cm
Stabilizant	- 10 cm

Fillimisht do te behet prerja e shtresave asfaltike sipas kufirit te nderhyrjes e me pas do behet skarifikimi i shtresave asfaltike ekzistuese.
Me pas do kryhet germimi ne forme kasonete sipas kuotave te projektit i trupit te rruges.
Kasoneta do cilindrohet dhe do verifikohet nese ka ndonje zone problematike qe do trajtim te vecante.
Me pas do te procedohet me shtresen e cakellit 25cm me ane te se ciles do realizohet edhe profilimi i rruges dhe kryqezimit si ne drejtim terthor ashtu edhe gjatesor. Per rrjedhoje trashesia e kesaj shtrese ne veper nuk do jete uniforme.
Shtresat do te kompaktohen me rrul vibrues duke i shoqeruar me lagie me uje.
Me pas do te ndertohet shtresa e stabilizantit 10cm.
Te gjitha shtresat do te kompaktohen me vibrim duke e shoqeruar me lagie me uje.
Me pas do te ndertohet shtresa e konglomerastit bituminoz me trashesi 10cm dhe shtresat asfaltike binder dhe asfaltobeton, perkatesisht 6cm dhe 4cm.

Zona e Trotuareve do te kete keto shtresa rrugore

Pllaka autobllok	8 cm	- 6 cm
Cakell (Zhavorr)		- 10 cm
Çakell (zhovorr)		- 10cm

Plan-Organizimi i Punimeve te Ndertimit

Para fillimit te punimeve, nga ana e kontraktorit do te paraqitet tek supervizori i objektit Plan-Organizimi per kantierin ne fjale. Ne kete faze nuk eshte paraqitur Plan-Organizimi, pasi dokumenti ne fjale ndryshon nga disponibiliteti i shoqerise ndertimore (kontraktorit) ne lidhje me makinerite, fuqine puntore, teknologjite ndertimore, etj..

Bordurat dhe Kunetat

Trupi i rrugëve do të kufizohet me bordurë Betoni Parafabrikat M-250 me përmasa 12x25cm 20x30cm të fiksuara me beton M-150. Bordura e rrugës do të vendoset mbi shtresat bazë të rrugës. (pasi mbi të në shumë raste takojnë apo ngjiten gomat e mjeteve.

Kunetat do të jenë e shtruar me Beton M-250 me gjeresi 50cm. Ato do vendosen paralel me rrugën (sheshin). Kuneta do te kete trashësi mesatare 10cm. (me ketë realizohet pjerrësia tërthore e kunetës.
Ne trotuare, prane kryqezimeve, ne vendet e kalimit te kembesoreve jane parashikuar dhe rampat per kalimin njerezve me aftesi te kufizuar.

Ne pjesen pedonale bordurat do te raalizohen me guri me permasa sipas vizatimeve.

2.3 – RRJETI K.U.SH.

Sistemi KUSH: Konceptimi i rrjetit te ujerave te bardha eshte bere duke ruajtur parimin e ndarjes se ujerave te zeza nga ato te bardha. Sistemi i largimit te ujerave te bardha eshte konceptuar kryesisht ne ndertimin e kunetave ujembledhese si dhe te pusetave te shiut ne te cilat do behet mbledhja e pas largimi i ujerave. Shkarkimi i ujrave te shiut do te behet ne kolektorin e rrjetit K.U.Z te zones. (Kolektorin qe kalon ne lindje te kryqezimit automobilistik). Ne pjesen e parkut, eshte parashikuar ndertimi I nje rrjeti drenazhimi. Rrjeti do te perbehet nga nje sistem tubazh drenazhi me D=150-200mm (shiko planimetrine perkatese). Tubat do te vendosen ne nje kanal me thellesi rreth 1m. Tubat e drenazhit do te rrethon me cakell makinerie me T=40-45mm. Paraprakisht i tere kanali do te vishet me gjeotekstil i cili do te qarkoje tere materialin inert, ne menyre qe grimcat e imta te mos depertojne ne tubacion. (shih vizatimet perkatese).

2.7 – KONKLUZIONE

Realizimi i punimeve per Projektin "Rikonstruksioni urban i sheshit mbrapa Bashkise", do ti jape qytetit te Peqinit nje frymemarrje te re dhe do permiresoje ndjeshem cilesine e sherbimit per banoret e kesaj lagje si dhe per femijet tij.

RAPORTI TEKNIK U HARTUA NGA DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE

Open Procurement Albania